



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

Tiranë, më 13 Janar 2025

Lënda: Kërkesë për informacion

Drejtuar: Z. Altin DUMANI
Drejtues i Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

I nderuar Z. Drejtues i Prokurorisë së Posaçme,

Me shkresën e datës 29.03.2024, me lëndë “*Informacion për fillimin e hetimeve penale ndaj shtetasit Olsi Rama*”, kemi vënë në dispozicionin tuaj disa indicie, të dhëna dhe informacione, të cilat në vlerësimin tonë krijojnë dyshime të arsyeshme për përfshirje në veprimtari të paligjshme të shtetasit Olsi Rama, të cilat duhet të verifikoheshin nëpërmjet një hetimi të plotë dhe të gjithëanshëm të SPAK, duke rihapur procedimin penal të veçuar nr. 335/1 të vitit 2016. Me shkresën nr. 6620/1 prot., datë 07.05.2024, jam informuar se SPAK ka vendosur rifillimin e hetimeve të pezulluara në lidhje me procedimin penal nr. 335/1 të vitit 2016, të rinumërtuar me procedimin penal me nr. 88/2024.

Në datën 10.01.2025, jam njohur nëpërmjet medias së shkruar me një reagim për televizionin “Vizion Plus” të Prokurorisë së Posaçme me përmbajtje si më poshtë vijon: “*Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka përfunduar hetimet për procedimin penal nr. 88 të vitit 2024, të regjistruar pas rifillimit të hetimeve të pezulluara të procedimit penal nr. 335/1 të vitit 2016. Ky procedim lidhet me veprat penale të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”, “Trafikimit të narkotikëve”, dhe “Kryerjes së veprave penale nga grupet e strukturuar kriminale”, të parashikuara në nenet përkatëse të Kodit Penal. Hetimet rifilluan pas administrimit të një informacioni të dërguar nga deputeti Gazment Bardhi, i cili pretendoi përfshirjen e shtetasit Olsi Rama në veprimtari të paligjshme. Në kuadër të këtyre hetimeve, SPAK ka kryer një sërë veprimesh hetimore, përfshirë bashkëpunimin me autoritetet kompetente të Kosovës. Nga hetimet ka rezultuar se nuk ekzistojnë prova apo fakte që lidhin shtetasin Olsi Rama me aktivitetin kriminal, për të cilin janë dënuar më parë disa individë. Gjithashtu, nuk janë identifikuar autorë të tjerë të mundshëm për veprat penale në fjalë. Në përputhje me nenin 326 të Kodit të Procedurës Penale, më datë 23 dhjetor 2024, është vendosur pezullimi i hetimeve për procedimin penal nr. 88 të vitit 2024, pasi autorët e tjerë të veprave penale nuk janë identifikuar. Dosja i është dërguar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për të vijuar përpjekjet për identifikimin e autorëve.”.*

Nisur nga sa më sipër dhe në kushtet kur unë si deputet i Kuvendit të Shqipërisë nuk kam pasur ndonjë njoftim me shkrim lidhur me këtë vendimarrje të Prokurorisë së Posaçme, megjithëse në reagimin publik pranohet se hetimet rifilluan pas administrimit të një informacioni të dërguar nga ana ime, në

mbështetje të nenit 8, të Ligjit nr. 8550, datë 18.11.1999 "Statusi i Deputetit", i ndryshuar, përcjell kërkesën për informacion si më poshtë:

A. Përfundimi i hetimeve për një procedim penal siç deklarohet në njoftimin tuaj publik dhe arritja e konkluzionit përfundimtar se nuk ekzistojnë prova apo fakte që lidhin shtetasin Ols Rama me aktivitet kriminal, nënkupton që nga ana e prokurorit të çështjes është nisur një procedim penal ndaj këtij shtetasi dhe për mungesë provash ai nuk rezulton i përfshirë në aktivitet të paligjshëm, dhe është vendosur "pushimi i hetimeve". Në këtë rast prokurori merr konfirmimin e GJKKO për "pushimin e procedimit ndaj shtetasit Ols Rama". Për pasojë, në kushtet kur hetimet kanë përfunduar dhe prokurori ka dalë në konkluzion lidhur me përfshirjen e shtetasit Ols Rama, ligjërisht duhet proceduar me dërgimin e kërkesës për pushimin e akuzës ose çështjes në ngarkim të këtij shtetasi, sipas nenit 329/a të Kodit të Procedurës Penale.

Përsa më lart, lutem të na vini në dispozicion:

1. Një kopje të vendimit të prokurorit për përfundimin e hetimeve dhe pushimin e procedimit penal ndaj shtetasit Ols Rama, për shkak se mungojnë provat dhe faktet që ai ka qenë i përfshirë në aktivitet kriminal.
2. Një kopje të kërkesës dërguar gjykatës për përfundimin e hetimeve dhe pushimin e procedimit penal ndaj shtetasit Ols Rama, si dhe vendimin gjyqësor respektiv, ku është pranuar kërkesa për përfundimin e hetimeve dhe pushimin e procedimit ndaj Ols Ramës, sipas konkluzionit që nuk ka prova që e lidhin atë me aktivitet kriminal.

B. Nga ana tjetër, në njoftimin publik thuhet se më datë 23 dhjetor 2024, është vendosur **pezullimi i hetimeve për pjesën tjetër** të procedimit penal nr. 88 të vitit 2024, pasi autorët e tjerë të veprave penale nuk janë identifikuar. Lidhur me këtë vendim të prokurorit, i cili nuk na është vënë në dispozicion si iniciues i kësaj procedure, lutem të na informoni se cilat janë veprimet hetimore të kryera nga SPAK në kuadër të procedimit penal me nr. 88 të vitit 2024, duke përfshirë provat e mbledhura, personat e pyetur, dokumentacionin e administruar etj., si dhe të na vini në dispozicion një kopje të vendimit për pezullimin e hetimeve të procedimit penal me nr. 88 të vitit 2024, të marrë më 23 dhjetor 2024, me qëllim që në përputhje me pikën 3 të nenit 326 të Kodit të Procedurës Penale të na jepet mundësia e ankimit të këtij vendimi për pezullim në Gjykatën e Posaçme.

Në informacionin sa më sipër, lutem të specifikoni veçanërisht çështjet që vlerësojmë se kanë interes për rrethanat e këtij hetimi, për të kuptuar nëse ka qenë i plotë dhe i gjithëanshëm, si më poshtë:

1. Procedimi penal nr. 335 i vitit 2016 filloi pas një kërkesë për ndihmë juridike nga ana e autoriteteve gjermane të drejtësisë, përkatësisht Prokuroria e Hanoverit. Gjatë hetimeve të kryera për procedimin penal nr. 88 të vitit 2024, a ka bashkëpunuar ose patur ndonjë komunikim zyrtar Prokuroria e Posaçme me Prokurorinë e Hanoverit?
2. Në datën 4 prill 2024, ministri i Brendshëm i kohës Taulant Balla ka informuar zyrtarisht seancën plenare të Kuvendit të Shqipërisë se është në dijeni se kush është personi i paidentifikuar i moshës 45 vjeç. A është pyetur Ministri i Brendshëm Taulant Balla si person që ka dijeni për rrethanat e çështjes apo ka përcjellë në cilësitë e tij zyrtare ndonjë informacion për SPAK lidhur me këtë çështje?

C. Në një dalje publike të datës 12 Janar 2025, Kryeministri i Shqipërisë Edi Rama ngriti pretendimin se nga ana ime janë krijuar “rrethana të rreme”, pra janë sajuar dokumente/fakte apo analiza. Nëse ky pretendim i Kryeministrit është i vërtetë, ngrihen pikëpyetje të forta mbi punën e SPAK, mbi arsyet dhe motivet që nxitën këtë organ të rifillonte hetimet për procedimin penal të pezulluar me nr. 355/1 viti 2016, duke e rinumërtuar me nr. 88 viti 2024.

Për të kuptuar nëse vërtetë prokuroria ka rifilluar pa shkak të ligjshëm një procedim të pezulluar, lutem mund të na informoni nëse nga hetimi juaj:

1. A ka arritur të identifikojë Prokuroria e Posaçme personin e paidentifikuar, të moshës 45 vjeç, përdorues i automjetit me targë AA653DM? Nëse po, kush ishte ky person? Nëse jo, cila është rrethana/prova/e dhena që ka krijuar bindjen e prokurorit se ky person nuk është Ols Rama? A ka qenë raporti i vëzhgimit policor i datës 13.01.2015, ora 15:50, i shoqëruar me fotografi të personit të paidentifikuar? A mund të na vini në dispozicion këtë raport së bashku me pamjet filmike që e shoqërojnë?
2. A ka rezultuar se shtetasi Ols Rama ishte përdorues i automjetit me targë AA653DM apo AA393FJ, që rezultojnë gjithashtu se janë përdorur në të njëjtën periudhë nga anëtarët e një organizate kriminale të dënuar për trafik droge (shtetasit Genti Xhixho, Ermal Hoxha dhe Gentjan Gjonaj)? Nëse po, sa është numri i hyrje-daljeve të tij me këtë automjet? A ka rezultuar se shtetasi Ols Rama kishte njohje, lidhje apo marrëdhënie shoqërore me personat e përfshirë në dosjen e laboratorit të drogës në Xibrakë? Nëse po, me cilët persona kishte lidhje, njohje apo marrëdhënie shtetasi Ols Rama?

Përfundimi i hetimeve nënkupton që informacioni i mbledhur dhe provat për arritjen e konkluzioneve nuk mbrohen më nga sekretet hetimor. Për këtë shkak, nuk ka asnjë pengesë ligjore për të përcjell informacionin si më sipër lidhur me provat e mbledhura, veprimet hetimore të kryera, me qëllim arritjen e këtij konkluzioni. Sipas ligjit, vendimi i pushimit apo pezullimit të një procedimi, i vihet në dispozicion personave të interesuar, të cilët gëzojnë të drejtën të kërkojnë kontroll gjyqësor mbi punën e prokurorit.

Transparenca e plotë mbi një çështje që paraqet interes publik, që përfshinë persona që sipas perceptimit të opinionit janë të paprekshëm për shkak të fuqisë politike të tyre apo të afërmëve të tyre, vlerësojmë se kontribuon në besimin e qytetarëve tek institucionet e drejtësisë. Mungesa e informacionit, shmangia e transparencës dhe mbyllja e dosjeve penale pa asnjë transparencë, rrit edhe më shumë perceptimin se drejtësia vijon të ruaj të paprekur individë që gëzojnë pushtet të fortë politik.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE:

**KRYETARI
Gazment BARDHI**